



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 12 prot.

Kamëz, më 22.01. 2024

V E N D I M

Nr 12 Datë 22 / 01 / 2024

MBI

“MIRATIMIN E EFEKTEVE FINANCIARE EKONOMIKE TË NXJERRJES JASHTË
PËRDORIMIT TË MATERIALEVE ME VLERË 2,403,163 LEKË”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 22.01.2024, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.09 Datë 16.01.2024 në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit nr.115/2014 “Për ndarjen Administrativo-Territoriale të Njërive të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë” Ligjit nr. 10296 datë. 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiarë e Kontrollin”, Udhëzimit të Ministrisë Financës nr. 30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njesitë e Sektorit Publik, Këshilli Bashkiak Kamëz”;

V E N D O S I:

1. Miratimin e listës së materialeve për nxjerrjen jashtë përdorimit të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Kamëz, sipas llogarisë së materialeve (327) – me vlerë 2,403,163 leke;
2. Lista e materialeve që do të nxirren jashtë përdorimit është e pasqyruar bashkëlidhur këtij vendimi sipas emërimit, njesisë matëse, çmimit, sasisë, vlerës dhe arsyes së daljes jashtë përdorimit për çdo material;
3. Materialet e nxjerra jashtë përdorimit nga komisioni përkatës, do të asgjesohen nga komisioni i ngritur me urdhër të titullarit.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.

KRYETAR KËSHILLI

Hysen KOLDASHI

